



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

KGJK, nr. 330/2015
Datë, 16 dhjetor 2015

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS, (KGJK) në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4 pika 1.8, 1.9, 1.10 dhe 1.15 të Ligjit nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 100, paragrafi 4 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës dhe nenit 4 pika 7 të Rregullores mbi Organizmin e Brendshëm të Gjykatave, në mbledhjen e mbajtur me 16 dhjetor 2015, nxjerr këtë

V E N D I M

1. Këshilli Gjyqësor i Kosovës cakton për Organin Përzgjedhës të Pavarur për Përzgjedhjen e anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit, gjyqtarët:
 - i) Valdete Daka, gjyqtare – Gjykata Supreme e Kosovës,
 - ii) Asllan Krasniqi, gjyqtar - Gjykata Themelore në Prishtinës, dhe
 - iii) Nebojša Boričić , gjyqtar –Gjykata Supreme e Kosovës.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Enver Peci,
Kryesues
Këshilli Gjyqësor i Kosovës

Kopje e vendimit i dërgohet:

- Kuvendit të Republikës së Kosovës
- Anëtareve të Komisionit
- Sekretariatit të KGJK-së
- Arkivit



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

KGJK, nr. 331/2015
Datë, 16 dhjetor 2015

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS, (KGJK) në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4 pika 1.8, 1.9, 1.10 dhe 1.15 të Ligjit nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe nenit 4 pika 7 të Rregullores mbi Organizmin e Brendshëm të Gjykatave, në mbledhjen e mbajtur me 16 dhjetor 2015, nxjerr këtë

V E N D I M
PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË PLANIT STRATEGJIK TË GJYQËSORIT PRILL 2014-TETOR
2015

1. Miratohen raporti i monitorimit të Planit Strategjik të Gjyqësorit prill 2014-tetor 2015;
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Enver Peci,
Kryesues
Këshilli Gjyqësor i Kosovës



Kopje e vendimit i dërgohet:

- Sekretariatit të KGJK-së
- Departamentit Ligjor SKGJK



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

KGJK, nr. 332/2015
Datë, 16 dhjetor 2015

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS, (KGJK) Në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4 pikat 1.8, 1.10, të Ligjit nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenin 6, paragraf 1.6, në mbledhjen e mbajtur me 16 dhjetor 2015, Këshilli Gjyqësor o Kosovës (KGJK), merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Memorandumi i Mirëkuptimit në mes në mes të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Këshillit Prokurorial të Kosovës-Prokuroria e Shtetit, Komisionit Qendror Zgjedhor dhe Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa për ndarjen dhe pagesën e shpenzimeve të energjisë elektrike të ujit.
2. Autorizohet kryesuesi i KGJK-së që të nënshkruaj Marrëveshjen e Mirëkuptimit sipas pikës 1 të këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Enver Doci,
Kryesues
Këshilli Gjyqësor i Kosovës



Kopje e vendimit i dërgohet:

- Sekretariatit të KGJK
- Palëve nënshkruese
- Arkivit



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

KGJK, nr. 333/2015

Datë, 16 dhjetor 2015

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS, (KGJK) Në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4 pikat 1.8, 1.10, të Ligjit nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenin 6, paragraf 1.6, në mbledhjen e mbajtur me 16 dhjetor 2015, Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Memorandumi i Mirëkuptimit në mes të Këshillit Gjyqësor të Kosovës - Këshillit Prokurorial të Kosovës-Prokuroria e Shtetit të Republikës së Kosovës, Komisionit Qendror Zgjedhor dhe Paneli Zgjedhor për Ankesa – Parashtrës dhe Policisë së Kosovës për të gjitha periudhat e procesit zgjedhor.
2. Autorizohet kryesuesi i KGJK-së që të nënshkruaj Marrëveshjen e Mirëkuptimit sipas pikës 1 të këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Enver Peci,

Kryesues

Këshilli Gjyqësor i Kosovës

Kopje e vendimit i dërgohet:

- Sekretariatit të KGJK
- Palëve nënshkruese
- Arkivit



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

Nr. 334/2015

Në bazë të nenit 4 parag. 1.8, 1.15 si dhe nenit 27 parag.1 dhe 6 të Ligjit Nr.03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, dhe në funksion të zbatimit të Udhëzimit Administrativ 01/2015 (me tutje: UA 01/2105) në zbatim të vendimit të KGJK-së për delegim të përgjegjësive në çështje të Personelit, Buxhetit dhe Financave, Prokurimit dhe Logjistikës, përfshirë plotësimet dhe ndryshime e miratuar, Këshilli Gjyqësor i Kosovës nxjerr këtë

V E N D I M

PËR DELEGIM TË PËRGJEGJËSIVE NGA SKGJK NË GJYKATA

- I. Nga data 1 janar 2016 të gjithë përgjegjësitë e Drejtorit të SKGJK si Zyrtar Kryesor Administrativ në lidhje me çështjet e personelit, buxhet dhe financa, logjistikë dhe prokurim barten tek kryetaret e gjykatave ashtu siç parasheh UA 01/2105 dhe tërë legjislacioni tjetër në fuqi.
- II. Nga data 1 janar 2016 të gjithë përgjegjësitë e Koordinatorit të Njesisë për Administratë dhe Personel të SKGJK në cilësinë e Menaxherit të Personelit, barten tek administratorët e gjykatave ashtu siç parasheh UA 01/2105 dhe tërë legjislacioni tjetër në fuqi.
- III. Nga data 1 janar 2016 të gjithë përgjegjësitë e Koordinatorit të Njesisë për Buxhet dhe Financa të SKGJK në cilësinë e Zyrtarit Kryesor Financiar barten tek zyrtarët e gjykatave ashtu siç parasheh UA 01/2105 dhe tërë legjislacioni tjetër në fuqi.
- IV. Nga data 1 janar 2016 të gjithë përgjegjësitë në lidhje me çështjet e prokurimit dhe logjistikës barten nga SKGJK tek zyrtarët e gjykatave ashtu siç parasheh UA 01/2105 dhe tërë legjislacioni tjetër në fuqi.
- V. Në rastet kur gjykatat nuk kanë arritur të bëjnë identifikimin e tërë personelit për të ushtruar veprimtarinë sipas pikave III dhe IV të këtij Vendimi, atëherë SKGJK do të vazhdojë të kryej punët e kërkuara nga gjykatat dhe në emër të gjykatave deri në rekrutimin dhe licencimin e zyrtarëve gjegjës.

VI. SKGjK obligohet që, përmes kërkesës në Ministrinë e Administratës Publike, t'u shpërndaj gjykatave Sistemin Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (SIMBNj) për ndërmarrjen e të gjitha veprimeve dhe në mënyrë të pavarur të kenë qasje dhe aprovim në sistemin SIMBNj për çështjet e personelit dhe formularët për autorizim dhe qasje ne sistemin 'freebalance' për ekzekutim të pagesave dhe kërkesën.

VII. Ky vendim hyn ne fuqi me 1 janar 2016.

Prishtinë, 16 dhjetor 2015

Enver Peci

Kryesues i Këshilli Gjyqësor të Kosovës



Kopjet e vendimit u dërgohen:

- *Kryetareve dhe administratorëve të gjykatave*
- *SKGjK*
- *Arkivit*



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

KGJK, nr. 336/2015
Datë, 16 dhjetor 2015

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS, (KGJK) në bazë të nenit 104 dhe 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 45 të Rregullores mbi Organizmin dhe Veprimtarin e Brendshme të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, nenit 2.2 të Ligjit, nr.04/L-274 Për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare në mes të Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian për sundimin e Ligjit në Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me 16 dhjetor 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet emërimi i z. Rene Van Veen si gjyqtar i EULEX-it që do të caktohet të punoj në gjykatat e Republikës së Kosovës.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Këshilli Gjyqësor i Kosovës

Kopje e vendimit i dërgohet:

- Zyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës
- Sekretariatit të KGJK-së
- EULEX-it
- Arkivit



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

KGJK, nr. 337/2015

Datë, 16 dhjetor 2015

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS, (KGJK) në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4 paragraf 1, pika 1.1 dhe 1.8 të Ligjit nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe nenet 45, 46 të Rregullores mbi organizimin dhe veprimtarinë e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-273 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që lidhen me mandatin e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Republikën e Kosovës dhe Marrëveshjes ndërmjet Shefit të EULEX-it dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) në aspektet relevante të veprimit dhe bashkëpunimit të gjyqtarëve të EULEX-it me gjyqtarët që punojnë në gjykatat vendore (Marrëveshja) nënshkruar më 18 qershor 2014 si dhe me kërkesë të EULEX-it në mbledhjen e mbajtur më 16 dhjetor 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

PËR APROVIMIN E KËRKESËS SË EULEX-IT PËR CAKTIMIN E GJYQTARËVE TË EULEX-IT NË LËNDËN PENALE P.NR.184/15 NË GJYKATËN THEMELORE NË MITROVICË

1. Aprovohet kërkesa e EULEX-it për caktimin e gjyqtarëve të EULEX-it në lëndën penale P.nr.184/15 kundër Xhemshit Krasniqi në Gjykatën Themelore në Mitrovicë .
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


A r s y e t i m

Prokuroria Speciale e Speciale e Republikës së Kosovës më datë 09 nëntor 2015 ka ngritur aktakuzë kundër Xhemshit Krasniqi për veprat penale Krim lufte kundër popullatës civile, (përfshirë torturën, trajtimin çnjerëzor, vuajtje të pafunsme apo cenimin e integritetit trupor apo të shëndetit, përdorimin e masave të frikësimit apo terrorit dhe vrasjen) në kundërshtim me nenin 142 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, tani e ndëshkueshme sipas nenit 152 të Kodit Penal të Kosovës (KPK) në shkellje të nenit 3, i përbashkët për Konventat e Gjenevës të vitit 1949 dhe

veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll dhe ose posedim të paautorizuar të armëve ne kundërshtim me nenin 374, paragrafi 1, lidhur me nenin 120, pika 38 të KPK-së

Kërkesa e EULEX-it që kjo çështje të caktohet nga një trup gjykues prej gjyqtarëve të EULEX-it është arsyetuar në ndjeshmërinë dhe kompleksitetin aktual të rastit, shkak i seriozitetit të akuzave, rasti penal është i ndjeshëm dhe lënda është shumë sensitive duke përfshirë akuzën për Krime Luftë kundër Popullatës Civile dhe se një veprim i tillë do të mundësojë kontinuitetin dhe efikasitetin e punës në gjykatë dhe për këtë arsye vendosi që kjo çështje të mbetet në kompetencë për gjykim të gjyqtarët e EULEX-it.

Andaj, duke u bazuar si në thëniet e sipërpërmendura u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.



Këshilli Gjyqësor i Kosovës

Kopje e vendimit i dërgohet:

1. *Malcom Simmons, kryetar i gjyqtarëve të EULEX-it*
2. *Drejtorit të Sekretariatit të KGJK*
3. *Kryetarit të gjykatës përkatëse*
4. *Arkivës së KGJK*



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

KGJK, nr. 338/2015
Datë, 16 dhjetor 2015

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS, (KGJK) në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4 parag 1, pika 1.1 dhe 1.8 të Ligjit nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe nenet 45, 46 të Rregullores mbi organizmin dhe veprimtarin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-273 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që lidhen me mandatin e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Republikën e Kosovës dhe Marrëveshjes ndërmjet Shefit të EULEX-it dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) në aspektet relevante të veprimit dhe bashkëpunimit të gjyqtarëve të EULEX-it me gjyqtarët që punojnë në gjykatat vendore (Marrëveshja) nënshkruar më 18 qershor 2014 si dhe me kërkesë të EULEX-it në mbledhjen e mbajtur me 16 dhjetor 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

PËR APROVIMIN E KËRKESËS SË EULEX-IT PËR CAKTIMIN E GJYQTARËVE TË EULEX-IT NË LËNDËN PENALE P.NR.186/15 NË GJYKATËN THEMELORE NË MITROVICË

1. Aprovohet kërkesa e EULEX-it për caktimin e gjyqtarëve të EULEX-it në lëndën penale P.nr.186/15 kundër Dejan Nedeljković në Gjykatën Themelore në Mitrovicë .
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore Mitrovicë më datë 13 nëntor 2015 ka ngritur aktakuzë kundër Dejan Nedeljković, për veprat penale lëndim i lehtë trupor në pajtim me nenin 188 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, paragrafin 2, shkaktim i rrezikut të përgjithshëm në pajtim me nenin 365 paragrafi , paragrafi 3 dhe veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve në pajtim me nenin 374 paragrafi 1 të Kodit Penal të Kosovës civile (KPK-së).

Kërkesa e EULEX-it që kjo çështje të caktohet nga një trup gjykues prej gjyqtarëve të EULEX-it është arsyetuar në ndjeshmërinë dhe kompleksitetin aktual të rastit që paraqet situatë të jashtëzakonshme që e justifikon caktimin e rastit gjyqtarëve të EULEX-it .

Këshilli Gjyqësor i Kosovës duke u bazuar në kërkesën e EULEX-it si dhe duke marrë parasysh rrethanat e rastit të ndjeshëm pasi që drejtëpërdrejtë ka të bëjë me veprat penale të kryera nga dhe kundër serbëve të Kosovës në veri të Mitrovicës, vlerësoi se një veprim i tillë do të mundësojë kontinuitetin dhe efikasitetin e punës në gjykatë dhe për këtë arsye vendosi që kjo çështje të mbetet në kompetencë për gjykim të gjyqtarët e EULEX-it.

Andaj, duke u bazuar si në thëniet e sipërpërmendura u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.



Enver Peci

Kryesues

Këshilli Gjyqësor i Kosovës

Kopje e vendimit i dërgohet:

- 1. Malcom Simmons, kryetar i gjyqtarëve të EULEX-it*
- 2. Drejtorit të Sekretariatit të KGJK*
- 3. Kryetarit të gjykatës përkatëse*
- 4. Arkivës së KGJK*



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

KGJK. nr. 339/2015
Datë, 16 dhjetor 2015

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS, (KGJK) në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4 parag 1, pika 1.1 dhe 1.8 të Ligjit nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe nenet 45, 46 të Rregullores mbi organizmin dhe veprimtarin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në përputhje me nenin 5.52 të Ligjit Nr. 04/L-273 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që lidhen me mandatin e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Republikën e Kosovës dhe kërkesë së EULEX-it në mbledhjen e mbajtur me 16 dhjetor 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

PËR REFUZIMIN E KËRKESES SË EULEX-IT, 2015.OPEJ.0115-0001 QË KOLEGJI I APELIT TË AKP-SË I GJYKATËS SUPREME TË PËRBËHET NGA SHUMICA E GJYQTARËVE TË EULEX-IT/NDËRKOMBËTAR

1. Refuzohet kërkesa e EULEX-it, 2015.OPEJ.0115-0001 që Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të përbëhet nga shumica e gjyqtarëve të EULEX-it/ndërkombëtar në lëndët për të cilat janë regjistruar ankesat pas datës 30 maj 2014.
2. EULEX-i në të ardhmen mund të parashtoj pran KGJK-së kërkesa të specifikuara për secilin rast veç e veç.
3. Vendimi hyn fuqi ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka pranuar kërkesën e EULEX-it numër 2015.OPEJ.0115-0001 me të cilën kërkohet që KGJK-ja të vendos për Kolegjin e Apelit të AKP-së të Gjykatës Supreme të përcaktuar si në dispozitiv që të përbëhet nga shumica e gjyqtarëve të EULEX-it/ndërkombëtar.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës duke u bazuar në nenin 5 pika 5.2 të Ligjit Nr.04/L-273 për Ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që lidhen me mandatin e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Republikën e Kosovës refuzoi kërkesën e EULEX-it duke vendosur që Kolegji i Apelit të KPA-së i Gjykatës Supreme të përbëhet nga shumica e gjyqtarëve vendor duke i lënë mundësinë

EULEX –it që në të ardhmen mund të parashtroj kërkesa të specifikuar pran KGJK- së duke arsyetuar secilin rast veç e veç.

Andaj duke u bazuar si në thëniet e sipërpërmendura u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kopje e vendimit i dërgohet:

1. Shefit të Misionit të EULEX në Kosovë
2. Drejtorit të Sekretariatit të KGJK
3. Kryetarit të gjykatës përkatëse
4. Arkivës së KGJK